

Workshop Discussions | MINUTES

WG 2: Parashikimi i të ardhurave dhe qendrueshmëria e tyre në nivelin vendor (analiza dhe rekomandime). Një qasje për të kontribuar në planin e masave për identifikimin e politikave në decentralizimin fiskal.

Ekspertë: Antonin Braho (DEA Consulting), Sabina Ymeri (ISB)

datë | 4/24/2014 11:00 AM | vendi Shkoder

Organizuar nga:	dldp	Moderator:	Elvin Hoxha
Formati i takimit:	Workshop me ekspertë të	Përmbledhja:	Erida Dobrusha
Pjesëmarrës (vendos nr dhe listen e pjesemarrësve bashkangjitur):	buxhetit dhe të ardhuravë në NJQV		

çështje e ngritura/pyetje

propozime/pë rgjigje

Burimet Njerezore në administratën tatimore:

Drejtuesit e fushës së tatim-taksave apo menaxhimit finciar në NJQV nuk janë pjesë e procesit të përzgjedhjes së administratës në varësi të sektorëve të tyre, pasi praktikisht ky pushtet/atribut ushtrohet vetëm nga Kryetari i NJQV-së. Për pasojë, edhe performanca administratës në këtë nivel lë për të dëshiruar. Kësisoj, në shumë raste detyrohen vet drejtuesit e këtyre sektorëve, që të plotësojnë boshllëqet duke u ekspozuar në terren.

Është i domosdoshëm forcimi real i kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore. Zbatimi i ligjit të ri për shërbimin civil në nivel vendor dhe mbështetja me instrumentat e duhur për garantimin e tij është një parakusht i rëndësishëm. Statusi i shërbimit civil në nivel vendor – certifikimi dhe kualifikimi i nëpunësve civil duhet të aplikohet si në nivel qendror dhe atë vendor. Duhet përcaktuar dhe verifikuar kriteret për rekrutimin (ky fenomen është në proces rregullimi nënligjor dhe rregullimi). Kjo do të çojë në garantimin e statusit dhe sigurisë së vendit të punës.

Niveli i ulët i pagave të punonjësve të NJQV-së, që punojnë në sektorin e financës dhe tatim-taksave, reflekton cilësinë e ulët të kapaciteteve humane të njësive vendore.

Shih më poshtë.

Gjendja e lartë e informalitetit dhe mungesës së informacionit zyrtar në lidhje me regjistrimin e bizneseve, godinave/objekteve, lëvizjes

Duhet bashkëpunim ndër-institucional në marrjen e

së popullsisë, apo aksesit në regjistrin e gjendjes civile, çon në vështirësinë e grumbullimit të të ardhurave.	informacionit zyrtar, i cili është edhe një detyrim ligjor për këto institucione. Zgjerimi i sistemit të veprimeve online për të mundësuar shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe aksesin tek të dhënat që lehtësojnë mirëmenaxhimin e taksave dhe tarifave.
Çështja e ndarjes së taksave apo taksat e përbashkëta, si formë për rritjen e efikasitetit:	Duhet të ndahen disa taksa ndërmjet pushtetit vendor dhe qendror. Në këtë mënyrë të dyja pushtetet do të jenë më të interesuara për të qene më të organizuara dhe bashkëpunuese me njëri-tjetrën për vjeljen e taksave të ndara, pasi autoriteti vendor është më afër tatimpaguesit dhe ka mundësi më direkte ta kontrollojë atë, ndërsa pushteti qendror do të mund të luajë një rol më mbështetës në këtë proces.
Fusha e veprimit të pushtetit lokal për nxitjen e zhvillimit ekonomik është e kufizuar p.sh mundësia e njohjes/krijimit të zonave të lira në territorin e NJQV-ve për mobilizimin e potencialit të ngrirë psh në zonat turistike	Ndoshta, këtu duhet ndërhyrje në legjislacion.
Një nga taksat më të rëndësishme për NJQV-të është ajo e ndërtesave, e cila mund të vlejë më lehtë për arsye të mundësisë së verifikimit dhe ndjeshmërisë ndaj pronës. Mirëpo marrja e informacionit nga hipotekat/ kadastrat (zyrat e regjistrimit të pasurive) nuk ka funksionuar siç duhet, edhe pse detyrim i njohur nga ligji. E njëjta gjë vlen edhe për Zyrën e ALUIZN-it.	Mund të propozohen sanksione për mosofrimin e informacionit zyrtar nga institucionet respektive, të cilat e kanë detyrim ligjor vënien në dispozicion të informacionit publik NJQV-ve.
E drejta e pushtetit vendor në administrimin e paketës fiskale.	NJQV-të duhet të kenë hapësirë ligjore në përcaktimin, ndryshimin apo shtimin e taksave (aktualisht NJQV-të nuk kanë të drejtë të ndyshojnë nivelin e përcaktuar nga ligji apo heqin ndonjë taksë). Diversifikimi i menaxhimit të paketës do e bënte atë më të përshtatshme për kushtet vendore.
Rritja e autonomisë dhe funksioneve të pushtetit vendor duhet të jetë graduale (sidomos në kushtet e reformave të pritshme) duke i lënë mundësinë dhe ofruar mjetet e nevojshme për shfrytëzimin e	Prioritet është autonomia fiskale, për të zgjeruar fushën e veprimit dhe mundësitë të NJQV-ve..

kushteve dhe hapësirave të reja. Duke qenë se informaliteti është kthyer në një problem real, i cili buron edhe nga regjistrimi dhe ç`regjistrimi i shpeshtë i bizneseve, është e nevojshme, që të aplikohen masa për vënien nën kontroll të kësaj situate.	Duhet të ketë një taksë vendore për regjistrimin e biznesit, në mënyrë që të kontrollohet apo kufizohet më shumë informaliteti i biznesit. QKR të jetë sa më afër pushtetit vendor (rasti i integritetit të QKR si pjesë e Zyrave me 1 Ndalesë) për të shkëmbyer lehtësisht informacionin dhe kushtëzuar ndërveprimet institucionale.
Funksionalizimi i sistemit të adresave, për efekt të informimit të publikimit.	Duhet që ky sistem të shfrytëzohet më mirë për informimin sa më të saktë dhe të shpeshtë të qytetarëve për detyrimet e tyre ndaj NJQV-së
Problem mbetet mënyra e vjeljes së detyrimeve nga emigrantët, pasi NJQV-të e kanë të vështirë ose të pamundur marrjen e informacionit të lëvizjes së tyre.	Koordinimi ndër-institucional për krijimin e një data-base me këtë qëllim do ishte një formë për formalizimin e marrëdhënies NJQV-komunitet emigrantësh.
Ndikimi i reformës territoriale në financat vendore.	Zbatimi i reformës territoriale duhet të bëhet i fazuar, pasi mund të ketë rënie drastike të të ardhurave në rast se bëhet i menjëhershëm.
Një pjesë e bizneseve të mëdha ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e komunave duke shfrytëzuar burimet e tyre.	NJQV-të duhet të kenë kompetenca edhe në vjeljen e taksave që lidhen me aktivitetin e biznesit të madh, në rastet kur qendra e këtij biznesi është në territorin e NJQV-së respektive.
Është e vështirë për tu monitoruar në kohë reale qarkullimin i të ardhurave brenda njësisë vendore, pasi informacioni nga dega e thesarit merret 2 javë me vonesë nga momenti që duhet të kryhet/përmbushen detyrimet.	Integrimi në një sistem online horizontal dhe vertikal i institucioneve do ishte një zgjidhje e efektshme.
Ndryshimi i ligjit pa një konsultim të gjerë me ekspertët dhe përfaqësuesit e NJQV-ve është i pakuptimtë. Aktualisht, ne po diskutojmë mbi një ligj, i cili do të ndryshojë menjëherë me miratimin e reformës territoriale. Duhet patur parasysh që ndryshimet e shpeshta ligjore në lidhje me paketën fiskale e dëmtojnë shumë pushtetin vendor në parashikimin dhe mbledhjen e të ardhurave.	Propozimi për ndryshimin e paketës ligjore duhet të jetë serioz, i konsultar dhe i përbashkët (nga NJQV-të). Duhet theksuar se ky legjislacion nuk duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve të shpeshta, pasi pushteti vendor ka nevojë për qendrueshmëri të legjislacionit

	fiskal.
Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) paguhet si nga punonjës të administratës qendrore, por edhe lokale ashtu si edhe nga subjektet private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e qeverisjes vendore, nga e cila marrin shërbime.	Duhet rekomanduar ndryshim ligjor për ndarjen e TAP: duhet që një pjesë e e TAP për të punësuarit në NJQV t'i rikthehet atyre.
Funksione te caktuara në raport me shërbime direkte ndaj popullsisë, si shërbimi shëndetësor parësor dhe edukimi, janë ende në një masë të konsiderueshme përgjegjësi e plotë ose e ndarë me qeverisjen qendrore. Në këtë rast edhe ndarja e fondit të pakushtëzuar duhet të jetë në raport me këtë përgjegjësi.	Kalimi gradual i këtyre shërbimeve në nivel të përgjegjësisë lokale, duhet të shoqërohet edhe me kalimin e taksave respektive. Ndërkohë, duhet vlerësuar se sa e aftë është qeverisja vendore për të asimiluar dhe përballuar sigurimin e këtyre shërbimeve.
Ka shërbime të cilat lidhen me funksione të përbashkëta ndërmjet pushtetit vendor dhe qendror. Ndërkohë, që ka legjislacion të ri në fuqi për mjedisin, i cili sjell kosto të larta NJQV-të për standartet që ka vendosur ligji. Gjithashtu, Shërbimet Sociale janë duke kryer një reformë e cila konsiston në një rol shumë aktiv të pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat nuk duhet të kufizohen vetëm në pagesat e llojit të paaftësisë.	Duhet rregulluar mekanizmat e përgjegjshmërisë së shërbimeve në nivel lokal, ku identifikohen shërbime të përbashkëta ndërmjet qeverisjes vendore dhe qendore.
Ekziston një praktikë e cila detyron NJQV-të që të mos kalojnë kufijtë e përqindjes të caktuar nga qeverisja qendrore për zëra të caktuar (psh. pagat) në administrimin e paketës së pakushtëzuar!	Nuk duhet të kushtëzohet më (në përqindje) mënyra e administrimit të paketës së pakushtëzuar, pasi kjo është e kundraligjshme, e megjithatë vazhdon të udhëzohet nga qeverisja qendrore.
Problem mbetet mungesa e transparences për ekualizimin fiskal nga qeverisja qendrore.	Shpjegimi më i qartë, konsultimi dhe lënia e kohës së nevojshme për reagim nga pushteti lokal në adresë të pushtetit vendor.
Janë pikërisht këto probleme që kërkojnë që NJQV-të të bëhen bashkë në ngritjen e kësaj problematike në tërësi, në mënyrë që pushteti qendror të mos vazhdojë të mos plotësojë detyrimet ligjore për të garantuar informacionin e nevojshëm nga i cili NJQV-të mund të identifikojnë dhe përmirësojnë mbledhjen e të ardhurave të tyre.	NJQV-të duhet që të shohin mundësinë dhe mekanizmat që ata kanë në dorë për të detyruar qeverisjen qendrore për t'ju përgjigjur nevojave të tyre. Duhet të ketë një paketë propozimesh se si mund të realizohet detyrimi, që lind nga problematikat e mësipërme.

Closing: 14: 05 PM